

**AKT I THEMELIMIT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“EcoTechSan” SH.P.K**

Sot, më 25/07/2023, në Elbasan, palët e mëposhtme (referuar në tekst kolektivisht si “**Ortakët Themelues**”, ose individualisht secili si “**Ortaku**”) bien dakord të miratojnë Aktin e Themelimit, si më poshtë :

1. **Armandi Terolli**, shtetas shqiptar, lindur në Korçë, më 27.04.1973, , me nr. Personal Identifikimi H30427213Q.

**I. Themelimi**

1. Ortakët themelues vendosën për themelimin e shoqërisë " **EcoTechSan** " Sh.p.k, nje shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar (“**Shoqëria**”).
2. Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në adresën : Lagjja Qemal Stafa, rruga 11 Nentori, zk.8522, pasuria 11/66, kati perdhe, Elbasan, Shqipëri.
3. Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pacaktuar.

**II. Objekti**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:

- Eksportim, Tregtim, Shitje, Blerje me shumice dhe pakice te lendeve dhe produkteve te ndertimit.
- Kompania ka te drejte qe te beje kerkime tregu afatshkurtera dhe afatgjata brenda dhe jashte vendit. Marrja pjese neper ankande dhe tendera, si dhe te beje sherbime qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se saj. Pregatitja e projekte investuese dhe trajnime fizibilituese, si dhe ti menaxhoje ato. Blerje pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, mjeteve te transportit t'i marre ose t'i leshoje me qera, te marre pjese ne tenderin e tyre, si dhe te beje ndertime, rikonstruktive, rregullime, sherbime, etj., apo te transferoje te palet e tjera punet e tyre, me pakice dhe shumice. Tregtim te materialeve te ndryshme, me pakice dhe shumice, ne format e parashikuara dhe te lejuara nga legjislacioni shqiptar. Shoqeria, mund te kryeje per permbushjen e qellimeve te saj cdo lloj operacioni tregtar, mund te vendose pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, ta hipotekojë kete pasuri ne regjistrin e pasurive te paluajtshme ne emer te saj. Mund te hyje ne tratativa dhe biznese me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie per te realizuar fitime ne fushat e permendura ne kete nen. Shoqeria, per te realizuar qellimin e saj, perdor te drejtat e pronesise, te mallrave te luajtshme dhe te paluajtshme, brenda dhe jashte vendit, ushtron veprimtari te ardhura dhe kursimi, krijon pengje dhe hipotekim mbi keto, perfiton, krijon, shlyen dhe ndan cdo lloj te drejte materiale, qeraje apo te drejta te mallrave te luajtshme dhe te paluajtshme. Kontraktimi, marrje apo dhenie, ne lidhje me fushen e veprimtarise, te cdo lloj kreditimi me afat te shkurter, te mesem dhe te gjate, ne tregjet e brendshme dhe te jashtme,

te mundesojë kredi mallrash, pengjesh, importimi dhe eksportimi. Perfitoje, transferoje, te marre apo jape me qera, te bleje dhe shese, si dhe te kontraktoje, te drejten e markes, patentes, licenses, dhe te drejtat e tjera qe jane te ngjashme me keto. Shoqeria, sic mund te ushtroje punet qe tregohen ne objektin e veprimtarise se saj, brenda dhe jashte vendit, ashtu dhe mund te marre pjese, te perfitoje apo te transferoje nga/te palet e tjera, mund te marre pjese ne kapitalet e personave juridike dhe fizike, te vendit apo te huaj, te krijuar ose qe krijohen me qellim tregtie, industrie, etj, ne lidhje me keto fusha.

- Te kryeje sherbime transporti dhe sherbime VIP (Ruajtjes fizike me truproje dhe sherbime me mjete te blinduara, transferime te vlerave monetare me automjete te blinduara).
- Pritje, akomodim me te gjitha llogjistiken e nevojshme per delegacione te huaja per te gjitha aktivitetet qe ata do te kryejne ne Republiken e Shqiperise.
- Tregti me shumice dhe pakice e artikujve elektroshtepiake.
- Tregti me shumice dhe pakice e artikujve hidrosanitare, hidraulike dhe bojra.
- Tregti pllakash dhe parketi.

### III. Statuti

Ortaku I vetem themelues me ane te kesaj deklarone miratimin e Statutit te Shoqerise .

### IV. Kapitali Themeltar

1. Kapitali fillestar i Shoqerise eshte 500,000 (peseqind mijë) Lekë. Cdo ortak zoteron 1 (nje) kuote me nje vlerë te pergjithshme nominale ne proporcion me kontributin e cdo ortaku ne kapitalin e Shoqerise

Ortakët zoterojne kapitalin si me poshte:

- **Armandi Terolli** – 100 % 500,000 (peseqind mijë) Lekë
2. Kuotat jane te zakonshme dhe secili ortak ka te drejta votimi *proporcionale* me vleren nominale te cdo kuote .
  3. Kapitali i Shoqerise paguhet plotesisht dhe nenshkruhet nga Ortakët Themelues.

## V. Administratori

1. Shoqëria menaxhohet nga 1 (një) Administrator i cili është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e përfaqëson atë te çdo pale e tretë. Numri i Administratorëve mund të ndryshohet nga Asambleja e Përgjithshme .
2. Administratori do të jetë përgjegjës për punët e përditshme të Shoqërisë, duke iu nënshtruar kufizimeve të parashikuara në Statut, ligjin e aplikueshëm dhe nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar dhe mund të riemërohet. Administratori i parë i Shoqërisë është:
  - **Sergi Terolli, shtetas shqiptar, lindur në Athinë, më 13.04.1999, me nr. Personal Identifikimi J90413079J.**

*Akti i Themelimit është hartuar në 3 ( tre ) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Akti i Themelimit është hartuar në pajtim me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.*

## Ortaku I vetëm I Shoqërisë

ABETAWSD TEROLLI  
9

**STATUT I SHOQERISE**  
**“EcoTechSan” SH.P.K.**

*Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.*

Sot, me 25/07/2023, në Tiranë, personi i mëposhtem:

**Z. Armandi Terolli**, shtetas shqiptar, lindur me 27.04.1973 ne Korçë e banues në Elbasan, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal identifikimi H30427213Q, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

ne përputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratuan këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 25/07/2023, themeluesi i mësipërm, vendosa të krijoj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar **“EcoTechSan” SH.P.K.**

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Eksportim, Tregtim, Shitje, Blerje me shumice dhe pakice te lendeve dhe produkteve te ndertimit.
- Kompania ka te drejte qe te beje kerkime tregu afatshkurtera dhe afatgjata brenda dhe jashte vendit. Marrja pjese neper ankande dhe tendera, si dhe te beje sherbime qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se saj. Prgatitja e projekte investuese dhe trajnime fizibilituese, si dhe ti menaxhoje ato. Blerje pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, mjeteve te transportit t'i marre ose

t'i leshoje me qera, te marre pjese ne tenderin e tyre, si dhe te beje ndertime, rikonstruktme, rregullime, sherbime, etj., apo te transferoje te palet e tjera punet e tyre, me pakice dhe shumice. Tregtim te materialeve te ndryshme, me pakice dhe shumice, ne format e parashikuara dhe te lejuara nga legjislacioni shqiptar. Shoqeria, mund te kryeje per permbushjen e qellimeve te saj cdo lloj operacioni tregtar, mund te vendose pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, ta hipotekojte kete pasuri ne regjistrin e pasurive te paluajtshme ne emer te saj. Mund te hyje ne tratativa dhe biznese me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie per te realizuar fitime ne fushat e permendura ne kete nen. Shoqeria, per te realizuar qellimin e saj, perdor te drejtat e pronesis, te mallrave te luajtshme dhe te paluajtshme, brenda dhe jashte vendit, ushtron veprimtari te ardhura dhe kursimi, krijon pengje dhe hipotekim mbi keto, perfiton, krijon, shlyen dhe ndan cdo lloj te drejte materiale, qeraje apo te drejta te mallrave te luajtshme dhe te paluajtshme. Kontraktimi, marrje apo dhenie, ne lidhje me fushen e veprimtarise, te cdo lloj kreditimi me afat te shkurter, te mesem dhe te gjate, ne tregjet e brendshme dhe te jashtme, te mundesoje kredi mallrash, pengjesh, importimi dhe eksportimi. Perfitoje, transferoje, te marre apo jape me qera, te bleje dhe shese, si dhe te kontraktoje, te drejten e markes, patentes, licenses, dhe te drejtat e tjera qe jane te ngjashme me keto. Shoqeria, sic mund te ushtroje punet qe tregohen ne objektin e veprimtarise se saj, brenda dhe jashte vendit, ashtu dhe mund te marre pjese, te perfitoje apo te transferoje nga/te palet e tjera, mund te marre pjese ne kapitalet e personave juridike dhe fizike, te vendit apo te huaj, te krijuar ose qe krijohen me qellim tregtie, industrie, etj, ne lidhje me keto fusha.

- Te kryeje sherbime transporti dhe sherbime VIP (Ruajtjes fizike me truproje dhe sherbime me mjete te blinduara, transferime te vlerave monetare me automjete te blinduara).
- Pritje, akomodim me te gjitha llogjistiken e nevojshme per delegacione te huaja per te gjitha aktivitetet qe ata do te kryejne ne Republiken e Shqiperise.
- Tregti me shumice dhe pakice e artikujve elektroshtepiake.
- Tregti me shumice dhe pakice e artikujve hidrosanitare, hidraulike dhe bojra.
- Tregti pllakash dhe parketi.

### **Neni 3 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e ***pacaktuar dhe/ose e pakufizuar***.

**Neni 4**  
**Selia**

4. Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Lagja Qemal Stafa, rruga 11 Nentori, zk.8522, pasuria 11/66, kati perdhe, Elbasan, Shqipëri.**

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

## **Kreu II Kapitali**

### **Neni 5 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **ALL 500.000 (pesëqind mijë lekë)** dhe zotërohet në masën 100% nga **Armandi Terolli**, zotërues i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme **500,000 (pesëqind mijë lekë)**.

Kontributi i ortakut është në para.

### **Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj. Çdo disponim në favor të një pale të tretë nëpërmjet veprimeve juridike ndërmjet të gjallëve duhet të behet në formë noteriale dhe të regjistrohet. Në rastet e transferimit të pjesëve të kapitalit me kundërshtëpërlim, ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

### **Neni 8 Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblesë të përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asamblesë të përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë të përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Per sa kohë që kapitali themeltar i Shoqërisë zotërohet nga një ortak i vetëm, ky i fundit do të ushtrojë kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.

## **Neni 9**

### **Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **Neni 10**

### **Kuorumi**



Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shpresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 11** **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet etjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

### **Neni 12** **Përfshirja nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënie ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13** **Administrimi**

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi: **Z. Sergi Terolli**, shtetas shqiptar, lindur në Athinë, më 13.04.1999, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. Personal **J90413079J**; madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

**Kreu IV**  
**Viti financiar-ekspertet**

**Neni 14**  
**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 15**  
**Ekspertet**

Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ia paraqesë e dorëzojë ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

**Kreu V**  
**Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë**

**Neni 16**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblesë se Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrine likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri ne likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftës isë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 17**  
**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

### **Neni 18**

#### **Baza**

#### **Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 19**

#### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt u hartua në gjuhën Shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortakët themelues si vijon:

### **ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“EcoTechSan” SH.P.K**

ARMANAD TEBOLLI  
